

Emri i Lëndës : E Drejtë Administrative II							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 212	B	Pranverë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lektori		Besa Ombashi, PhD					
Asistenti		Erisa Datja, MSc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Lënda “E Drejta Administrative” studion mënyrën e organizimit dhe rregullat bazë të funksionimit të administratës shtetërore gjatë procesit të vendimmarrjes dhe shqyrtimit të procedimeve administrative. Kjo lëndë studion elementet bazë të këtij procedimi duke dhënë koncepte të detajuara mbi mënyrën e veprimit, organizimin kolegjal, kuorumin gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes, mënyrën e përfundimit të procedimit etj. Lënda është konceptuar të trajtojë pjesën e posaçme të së drejtës administrative. Në këtë mënyrë, fillimisht bëhet trajtimi i aktit administrativ duke analizuar formën, përmbajtjen dhe veçoritë e aktit. Më pas, lënda vijon me evidentimin e rasteve të vlefshmërisë dhe të pavlefshmërisë së aktit administrative, fuqinë juridike të aktit dhe pushimin e fuqisë juridike. Një rëndësi e veçantë në këtë lëndë i jepet edhe ankimit administrativ duke shpjeguar afatet dhe fazat kur mund të shqyrtohet ankimi administrativ. Krahas këtyre, lënda merret edhe me analizën e Ligjit për Gjykatat Administrative me qëllim identifikimin e ndryshimeve të reja ligjore.					
Objektivat		Ky kurs synon: 1. Të japë njohuri të plota mbi aktin administrativ. 2. Të njohë studentët me mënyrën e shfaqjes së vullnetit administrativ të organeve të administratës publike. 3. T’u mundësojë studentëve përvetësimin e zgjidhjeve që u bëhet nga praktika administrative gjyqësore mosmarrëveshjeve administrative që lindin mes subjekteve të ndryshme si ato shtetërore ashtu edhe private. 4. T’i aftësojë studentët në perceptimin e llojeve të ankimit që mund të bëhen në rastet e konflikteve në këtë fushë. 5. T’i njohë studentët me rastet kur mund të kërkohet apo konstatohet pavlefshmëria e akteve juridike. 6. T’i njohë studentët me legjislacionin aktual për sa i përket pjesës së posaçme të së drejtës administrative. 7. T’u shpjegojë studentëve ligjin e ri për Gjykatat Administrative duke evidentuar ndryshimet përkatëse që janë bërë nga ligjvënësi. 8. T’i aftësojë studentët për të qenë të gatshëm të bëhen pjesë e diskutimeve konstruktive me anë të mendimit kritik të tyre.					
Konceptet Kryesore		1. Akt administrativ 2. Pavlefshmëri absolute 3. Pavlefshmëri relative 4. Ankim administrativ 5. Procedim administrativ 6. Kontrata administrative 7. Gjykata administrative					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Akti administrativ dhe veçoritë e tij Përkufizimi i, forma përmbajtja, qëllimi dhe arsyeimi i aktit administrativ; akti administrativ është akt juridik, akti i njëanshëm, specifikë e organeve që kryejnë veprimtari administrative, është akt nënligjor, dallimi me vendimet gjyqësore. (S. Sadushi, E drejta adminstrative 2, fq. 13-48)					
2		Klasifikimi i aktit administrativ dhe fuqia juridike e tij Klasifikimi sipas nismës për nxjerrjen e aktit, sipas formës së shprehjes së vullnetit; sipas efekti që sjell, sipas karakterit të përmbajtjes; emërtimet e akteve sipas organeve; kutimi i fuqisë juridike, nxjerrja e aktit, njohja e përmbajtjes së aktit, efekti i vonuar; hyrja në fuqi; efekti prapaveprues (S. Sadushi, E drejta adminstrative 2, fq. 50-108)					

3	Vlefshëmria e aktit administrativ Kërkesat e vlefshmërisë së aktit, kompetenca, juridiksioni, delegimi, zëvendësimi, spostimi; procedura paraprake, gjatë nxjerrjes së aktit, pas miratimit të aktit; përputhja e aktit me përmbajtjen e ligjit; përputhja e aktit me qëllimin e ligjit. (S. Sadushi, E drejta administrative 2, fq. 110-145)
4	Pavlefshmëria e aktit administrativ Kuptimi i pavlefshmërisë së aktit, pavlefshmëria relative, pavlefshmëria absolute; dallimi midis pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative, legjitimimi, disponimi, parashkrimi, efekti prapaveprues, rëndësia e shkeljes, eliminimi i pavlefshmërisë; kundërshtimi i pavlefshmërisë së aktit administrativ. (S. Sadushi, E drejta administrative 2, fq. 147-176)
5	Pushimi i fuqisë juridike të aktit administrativ Kuptimi për pushimin e fuqisë juridike; pushimi faktik; pushimi juridik, revokimi i aktit nga vetë organi, shfuqizimi nga organi epror, anulimi i aktit nga gjykata; ndreqja e gabimeve materiale në aktin administrativ. (S. Sadushi, E drejta administrative 2, fq. 179-202)
6	Ankimi administrativ Ankimi si mjet për ushtrimin e kontrollit administrativ; format e realizimit të ankimit; efektet e ankimit administrativ; shqyrtimi i ankimit administrativ; afati i ankimit administrativ; fazat e shqyrtimit të ankimit administrativ. (S. Sadushi, E drejta administrative 2, fq. 204-234)
7	Ekzektimi i aktit administrativ Kuptimi për ekzekutimin administrativ; mënyrat e ekzekutimit të aktit administrativ; procedura për ekzekutimin e aktit administrativ; aktet administrative të paekzekuteshme. (S. Sadushi, E drejta administrative 2, fq. 235-246)
8	Provimi gjysëmfinal
9	Procedimi administrativ Palët në procedimin administrativ; fillimi i procedimit administrativ; veprimet që kryhen gjatë procedimit administrativ; parimet që duhet të repektohen; përfundimi i procedimit administrativ, vendim përfundimtar, tërheqja e pretendimeve ose heqja dorë prej tyre, braktisja, pamundësia. (S. Sadushi, E drejta administrative 2, fq. 247-264)
10	Kontrata administrative Natyra e kontratave administrative; kontratta administrative sipas legjislacionit shqiptar; kërkesat e ligjshmërisë; kontratat e pavlefshme; ndryshimi dhe shfuqizimi i kontratave administrative; detyrimi i kontratave. (S. Sadushi, E drejta administrative 2, fq. 343-362)
11	Akti real administrativ Kuptimi i përgjithshëm i aktit real; vecoritë e aktit real; eliminimi i paligjshmërisë së aktit real. (S. Sadushi, E drejta administrative 2, fq. 364-373)
12	Rishikimi gjyqësor i aktit administrativ
13	Analizë e ligjit për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative
14	Analizë e ligjit për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (vazhdim)
15	Përsëritje
16	Final Exam

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• 1.Sokol Sadushi, E drejta administrative 2 (Tiranë 2008)
Referenca të tjera	• 1. Alma Faskaj, Procedimi administrative në Republikën e Shqipërisë (Tiranë 2013) 2. Ermir Dobjani, Erlir Puto, Elsa Toska & Erajd Dobjani, E drejta administrative, Kontrolli mbi administratën publike (Prishtinë 2013) 3. Eralda Met-Hasani, Kuptimi i administratës publike sipas legjislacionit të vendit tonë, Studime Juridike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Dhjetor 2007 4. Eralda Met-Hasani, Etika në administratën publike, Studime Juridike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Nr. 1, 2011 5. Eralda Met-Hasani, Enti Publik: risi e legjislacionit te vendit tone, Trajtime Juridike, Shkolla e Magjistraturës, Mars 2003 6. “Komentari i Kodit të Procedurave Administrative”, ISPL (Instituti për Studime Publike & Ligjore), Tiranë 2003 7. Zaganjori, Anastasi, (Methasani) Çani, Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Adelprint, Tiranë, 2011 8. Zaganjori, (Methasani) Çani, Alimehmeti, Shteti i së Drejtës dhe qeverisja vendore, Tiranë, 2013 9. Eralda (Met-Hasani) Çani, Studim Doktorature mbi Këshillin e Ministrave, Biblioteka e Fakultetit të Drejtësisë, UT, Tiranë, Tetor, 2008 10. Sokol Sadushi, DREJTËSIA KUSHTETUESE NË ZHVILLIM, Tiranë, 2012
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të kenë mundësi të njihen teorikisht me legjislacionin në fuqi mbi të drejtën administrative.
2	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë aktin dhe format e aktit administrativ.
3	Studentët do të kenë njohuri të mirëfillta përsa i përket fuqisë juridike dhe pushimit të fuqisë juridike të aktit.
4	Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë dallimin mes llojeve të pavlefshmërisë së aktit administrativ.
5	Studentët do të jenë në gjendje të përdorin praktikisht mekanizmat ligjorë të së drejtës asministrative në mbrojtjen e interesave ligjorë të personave që hyjnë në marrëdhënie me administratën publike në vend.
6	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë ndryshimet e reja ligjore në fushën e së drejtës administrative.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			30
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			70
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00